

Shoqata e Juristëve Shqiptaro-Britanik, si një promovuese e sundimit të ligjit dhe qasjes në drejtësi, plotësisht përkrah procesin e reformës në drejtësi në Shqipëri. Ky process është i nevojshëm në mënyrë që sundimi i ligjit, i cili është esencial për një shoqëri demokratike, të respektohet dhe të fitoj gjithmonë. Shoqata e Juristëve Shqiptaro-Britanik përkrah reforma të cilat sigurojnë, përveç tjerash, që sistemi gjyqësor në Shqipëri t'i përgjigjet popullit dhe të jetë i pavarur nga influencat politike dhe influencat tjera. Një reformë ligjore fundamentale është e nevojshme në Shqipëri jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave ligjore të qytetarëve të Shqipërisë, por gjithashtu për të siguruar që Shqipëria përparon në rrugën e saj të arritjes së një demokracie e cila funksionon si duhet.